



SPECIALIST PROSECUTOR'S OFFICE
ZYRA E PROKURORIT TË SPECIALIZUAR
SPECIJALIZOVANO TUŽILAŠTVO

Numri: KSC-BC-2020-04
Vendos: Gjykatësi i procedurës paraprake
Gjykatës Nikola Giju
Administratore: Dr. Fidelma Donlon
Pjesëmarrës parashtrues: Prokurori i Specializuar
Data: 26 prill 2021
Gjuha: Anglishte
Klasifikimi: Publik

Version i redaktuar publik i

**'Parashtrimi të Aktakuzës së Rishikuar për konfirmim dhe kërkesa lidhur me të'
parashtrimi KSC-BC-2020-04/F00004 i datës 18 mars 2020**

me shtojcën publike 1

Zyra e Prokurorit të Specializuar

Xhek Smith

Mbrojtësit të të akuzuarit

Z. Zhan-Lui Zhilisen

I. HYRJE

1. Në pajtim me Urdhrin,¹ nenin 38(4) të Ligjit,² dhe rregullën 86(2)-(4) të Rregullores,³ Zyra e Prokurorit të Specializuar ('ZPS') dorëzon për protokollim:
 - a. një aktakuzë të rishikuar për konfirmim, kundër Pjetër SHALËS, i njohur edhe me pseudonimin 'Ujku', në lidhje me krime të kryera në Kukës, Shqipëri, në vitin 1999 ('Aktakuza e Rishikuar');⁴
 - b. një përmbledhje të përditësuar në bazë të rregullës 86(3)(b), që përfshin material provues shtesë për ekzistencën e një konflikti të armatosur me karakter jondërkombëtar ndërmjet UÇK-së dhe forcave të Republikës Federale të Jugosllavisë dhe Republikës së Serbisë gjatë periudhës midis 17 majit dhe 5 qershorit 1999, si dhe një numër të vogël qartësimesh;⁵
 - c. parashtrime lidhur me juridiksionin e Dhomave të Specializuara mbi krimin e luftës të ndalimit arbitrar sipas nenit 14(1)(c), sikurse është parashtruar, ose sipas nenit 142 të Kodit Penal të Republikës Socialiste Federative të Jugosllavisë (1976), i përfshirë në nenin 15(1)(a), së bashku me elementët juridikë të tij; dhe
 - d. një fotografi të Pjetër SHALËS, të kohëve të fundit.⁶

¹ Urdhër Prokurorit të Specializuar në pajtim me rregullën 86(4) të Rregullores, KSC-BC-2020-04/F00003, 28 shkurt 2020, rreptësisht konfidencial dhe *ex parte* ('Urdhri'), para. 21. Më 14 shkurt 2020, ZPS-ja fillimisht dorëzoi një aktakuzë kundër Pjetër SHALËS për konfirmim. *Shih* Parashtrim i aktakuzës për konfirmim dhe kërkesa të lidhura me të, KSC-BC-2020-05/F00002, 14 shkurt 2020, rreptësisht konfidencial dhe *ex parte* ('Parashtrimi Fillestar').

² Ligji nr. 05/L-053 për Dhomat e Specializuara dhe Zyrën e Prokurorit të Specializuar, 3 gusht 2015 ('Ligji'). Përveç nëse specifikohet ndryshe, çdo referencë për 'neni/nenet' i referohet Ligjit.

³ Rregullorja e Procedurës dhe e Provave para Dhomave të Specializuara të Kosovës, KSC-BD-03/Rev1/2017, 5 korrik 2017 ('Rregullorja'). Përveç nëse specifikohet ndryshe, çdo referencë për "rregulla/rregullat" i referohet Rregullores.

⁴ Shtojca 1. *Shih* Urdhri, KSC-BC-2020-04/F00003, para. 21(c).

⁵ Shtojca 2 (përveç korrigjimeve të vogla tipografike, ndryshimet e bëra janë tek Elementët Kontekstualë, elementi 1; Pika 1 (ndalimi arbitrar), elementi 1; Pika 2 (trajtimi mizor), elementi 1; Pika 3 (tortura), elementi 2 dhe elementi 3 (i ri)). Materiali provues shtesë që mbështet ekzistencën e konfliktit të armatosur është dorëzuar si paketë më vete përmes sistemit elektronik *Legal WorkFlow*. *Shih* Urdhri, KSC-BC-2020-04/F00003, para. 21(b).

⁶ Shtojca 3. *Shih* Urdhri, KSC-BC-2020-04/F00003, para. 21(a).

II. AKTAKUZA E RISHIKUAR

2. Aktakuza e Rishikuar (i) paraqet hollësi dhe informacion identifikues të mëtejshëm për Pjetër SHALËN,⁷ (ii) ofron më shumë specifikime në lidhje me paraqitjen e fakteve,⁸ dhe (iii) qartëson karakterizimin juridik të atyre fakteve materiale.⁹

3. Aktakuza e Rishikuar, që duhet lexuar në tërësinë e saj,¹⁰ parashtron faktet materiale në rrethanat e veçanta të çështjes së ZPS-së kundër Pjetër SHALËS,¹¹ por jo provat që do të përdoren për t'i vërtetuar këto fakte.¹²

⁷ Urdhri, KSC-BC-2020-04/F00003, para. 21(c)(i).

⁸ Urdhri, KSC-BC-2020-04/F00003, para. 21(c)(ii).

⁹ Urdhri, KSC-BC-2020-04/F00003, para. 21(c)(iii).

¹⁰ SCSL/GJSSL, *Prosecutor v. Sesay et al.*, SCSL-04-15-A, Aktgjykim, 26 tetor 2009 ('*Sesay et al.*, Aktgjykim i Apelit'), para. 86 dhe burimet e cituara në të; ICTY/TPNJ, *Prosecutor v. Popović et al./Prokurori kundër Popović et al.*, IT-05-88-A, Aktgjykim, 30 janar 2015 ('*Popović et al.*, Aktgjykim i Apelit'), para. 37, 68 dhe burimet e cituara në të.

¹¹ Urdhri, KSC-BC-2020-04/F00003, para. 15.

¹² Fakte materiale janë ato që janë të nevojshme për të përmbushur kushtet e elementëve të krimeve dhe formave të përgjegjësisë penale të pretenduara dhe varen nga rrethanat e veçanta të çështjes. Faktet materiale – mbi të cilat mbështetet Prokuroria dhe të cilat duhet të përfshihen në aktakuzë – duhet të dallohen nga provat me anë të cilave duhen të provohen këto fakte materiale. *Shih* rregullën 86(3)(a) (bërja e dallimit ndërmjet 'fakteve materiale' dhe materialit provues që mbështet këto fakte); Urdhri, KSC-BC-2020-05/F00003, para. 12, 14-17; *Sesay et al.*, Aktgjykim i Apelit, para. 143 dhe burimet e cituara në të; ECtHR/GJEDNJ, *Previti v. Italy*, Kërkesë nr. 45291/06, *Decision on Admissibility*, 8 dhjetor 2009, para. 203-210 dhe burimet e cituara në të; ICC/GJPN, *Prosecutor v. Gbagbo*, ICC-02/11-01/11, *Decision on the date of the confirmation of charges hearing and proceedings leading thereto*, 14 dhjetor 2012, para. 27-29 dhe burimet e cituara në të; STL/TSL, *Ayyash et al.*, STL-11-01/PT/TC, *Decision on Alleged Defects in the Form of the Amended Indictment of 21 June 2013*, 13 shtator 2013 ('Vendimi i TSL-së'), para. 17 dhe burimet e cituara në të; *Popović et al.*, Aktgjykim i Apelit, para. 47 dhe burimet e cituara në të; ECtHR/GJEDNJ, *Sampech v. Italy*, Kërkesë nr. 55546/09, Vendim, 19 maj 2015, para. 105-112; ICC/GJPN, *Chambers Practice Manual*, maj 2017, f. 12. Në *Previti* (para. 208) dhe në *Sampech* (para. 110), GJEDNJ vërejt se instrumentet e akuzës për nga vetë natyra e tyre hartoheshin në mënyrë koncize dhe njoftimi i hollësive të mëtejshme për sjelljen e pretenduar rezultonte nga dokumente të tjera, si ato të procedurës paraprake dhe provat materiale në dosjen e çështjes. *Shih gjithashtu* ICC/GJPN, *Prosecutor v. Lubanga*, ICC-01/04-01/06, *Judgment on the appeal of Mr Thomas Lubanga Dyilo against his conviction*, 1 dhjetor 2014, para. 128-130; Vendimi i TSL-së, para. 17, 27. Nuk ka ndonjë përcaktim lidhur me formën në të cilën duhet të bëhet njoftimi dhe drejtësia e procedurave duhet vlerësuar në kuadër të procedurave në tërësi. *Shih* ECtHR/GJEDNJ, *Pélissier and Sassi v. France*, Kërkesë nr. 25444/94, Aktgjykim, 25 mars 1999, para. 46, 53.

4. Në rastet kur në Aktgjykimin e Rishikuar pretendohet kryerje fizike,¹³ ZPS-ja ka dhënë hollësi të mëtejshme për identitetin e viktimave, vendin dhe datën e përafërt, mënyrën dhe mjetet e kryerjes, dhe elementin mendor lidhur me të.¹⁴

5. Në përputhje me Urdhrin, kur pretendohet ndërmarrje kriminale e përbashkët dhe ndihmë dhe inkurajim, por jo kryerje fizike,¹⁵ ZPS-ja parashtron faktet materiale për këto forma të përgjegjësisë penale¹⁶ dhe në lidhje me krimet, vendet, kohën dhe numrin e përafërt të viktimave.¹⁷

6. Aktakuza e Rishikuar dhe materiali mbështetës demonstrojnë se ekziston dyshimi i bazuar mirë¹⁸ që Pjetër SHALA ka kryer ose ka marrë pjesë në kryerjen e krimeve brenda juridiksionit të Dhomave të Specializuara. Rrjedhimisht, ZPS-ja kërkon nga gjykatësi i procedurës paraprake që ta konfirmojë Aktakuzën e Rishikuar.

¹³ Shtojca 1, para. 13.

¹⁴ Urdhri, KSC-BC-2020-04/F00003, para. 16.

¹⁵ Shtojca 1, para. 8-12.

¹⁶ Urdhri, KSC-BC-2020-04/F00003, para. 12; IRMCT, *Ngirabatware v. Prosecutor*, MICT-12-29-A, Aktgjykim, 18 dhjetor 2014, para. 248 dhe burimet e cituara në të (lidhur me ndërmarrjen kriminale të përbashkët, Prokuroria duhet të parashtojë faktet materiale në vijim: natyrën dhe qëllimin e ndërmarrjes, periudhën gjatë së cilës thuhet se ka ekzistuar ndërmarrja, identitetin e pjesëmarrësve në ndërmarrje, natyrën e pjesëmarrjes së të akuzuarit në ndërmarrje dhe formën e ndërmarrjes kriminale të përbashkët të pretenduar); ICTR/TPNR, *Ntawukulilyayo v. Prosecutor*, ICTR-05-82-A, Aktgjykim, 14 dhjetor 2011, para. 188 dhe burimet e cituara në të (nëse pretendohet se i akuzuari planifikoi, nxiti, urdhëroi, ose ndihmoi dhe inkurajoi planifikimin, përgatitjen, ose kryerjen e krimeve të pretenduara, nga prokuroria kërkohet që të identifikojë veprimet përkatëse ose praktikën e sjelljeve përkatëse të të akuzuarit, që përbën bazën e akuzave në fjalë).

¹⁷ Urdhri, KSC-BC-2020-04/F00003, para. 17. Ndërsa afërsia e të akuzuarit me krimet bëhet më e largët, në lidhje me ato hollësi të veçanta kërkohet më pak saktësi, dhe theksi i vihet më shumë sjelljes së të akuzuarit mbi të cilën mbështetet prokuroria për të përcaktuar përgjegjësinë për krimet e kryera fizikisht prej të tjerëve. *Shih* ICTY/TPNJ, *Prosecutor v. Kvočka/Prokurori kundër Kvoçkës*, IT-98-30/1-A, Aktgjykim, 28 shkurt 2005, para. 65. Më tej, në rastet kur pretendohet se krimet ishin ngjarje të rregullta dhe/ose kishin vazhduar gjatë një periudhe të caktuar kohore, aftësia e të akuzuarit për të përgatitur mbrojtjen nuk varet nga hollësitë e incidenteve konkrete. *Shih, për shembull*, ICTY/TPNJ, *Prosecutor v. Naletilić and Martinović/Prokurori kundër Naletiliqit dhe Martinoviqit*, IT-98-34-A, Aktgjykim, 3 maj 2006, para. 89; ICTR/TPNR, *Ndindabahizi v. Prosecutor*, ICTR-01-71-A, Aktgjykim, 16 janar 2007, para. 21-22; ICTR/TPNR, *Rukundo v. Prosecutor*, ICTR-2001-70-A, Aktgjykim, 20 tetor 2010, para. 163.

¹⁸ Neni 38(4) dhe rregulla 86(1). *Shih gjithashtu* Kosovë, Kodi nr. 04/L-123 i Procedurës Penale, 2012 ('KPP'), neni 19(1.12) ('Dyshimi i bazuar mirë – nënkupton ngritjen e aktakuzës. Posedimi i provave të pranueshme që do të bindte një vëzhgues objektiv që një vepër penale ka ndodhur dhe që është kryer nga i pandehuri').

III. KËRKESA TË LIDHURA

7. Si pjesë e Parashtrimit Fillestar të saj, ZPS-ja kërkoi që gjykatësi i procedurës paraprake (i) të lëshonte një fletarrestim, një autorizim për kontroll dhe sekuestrim dhe një urdhër për transferim; (ii) të urdhëronte mosbërjen publike të aktakuzës, dokumenteve ose të informacionit të lidhur me të deri në një urdhër të mëtejshëm; dhe (iii) të urdhëronte mosnxjerrjen e përkohshme të identitetit të dëshmitarëve dhe viktimave në materialin mbështetës deri në urdhërimin e masave mbrojtëse të përshtatshme.¹⁹ ZPS-ja i përsërit këto kërkesa në lidhje me këtë parashtrim të Aktakuzës së Rishikuar dhe i përfshin parashtrimet e lidhura me të përmes referimit.

8. Më tej, në bazë të rregullës 105 dhe për të njëjtat arsye të renditura në Parashtrimin Fillestar,²⁰ ZPS-ja kërkon që gjykatësi i procedurës paraprake:

- a. të urdhërojë që emri dhe informacioni identifikues i çdo dëshmitari ose viktime të identifikuar në Aktakuzën e Rishikuar të mos i bëhet i njohur publikut;
- b. të autorizojë ZPS-në që të redaktojë identitetin dhe informacionin identifikues të dëshmitarëve dhe viktimave të përmendur në Aktakuzën e Rishikuar dhe t'u caktojë atyre pseudonime të përkohshme përpara se ajo t'i bëhet e njohur të akuzuarit ose publikut; dhe
- c. të urdhërojë që kjo mosnxjerrje e përkohshme të vazhdojë deri në një urdhër të mëtejshëm të gjykatësit të procedurës paraprake, në bazë të kërkesës së ZPS-së, apo pasi të ketë dëgjuar argumentet e ZPS-së.

IV. NDALIM ARBITRAR

9. Sikurse parashtrohet në vijim, ndalimi arbitrar përbën një shkelje të rëndë të nenit të përbashkët 3²¹ dhe rrjedhimisht përfshihet në juridiksionin e Dhomave të Specializuara në pajtim me nenin 14(1)(c).

¹⁹ Parashtrimi Fillestar, KSC-BC-2020-05/F00002, para. 4-22, 24.

²⁰ Parashtrimi Fillestar, KSC-BC-2020-05/F00002, para. 21.

²¹ Neni i përbashkët 3 i Konventave të Gjenevës të vitit 1949 ('neni i përbashkët 3').

10. Ndalimi arbitrar, i përshkruar si 'arrestim dhe ndalim i paligjshëm', parashihet si vepër penale sipas nenit 142 të Kodit Penal të Republikës Socialiste Federative të Jugosllavisë (1976) ('Kodi i RFJ-së'), dhe përfshihet në juridiksionin e Dhomave të Specializuara përmes nenit 15(1)(a).

a. Ndalimi arbitrar është shkelje e nenit të përbashkët 3

11. Neni i përbashkët 3 përcakton, ndër të tjera, se të gjithë personat që nuk marrin pjesë aktive në luftime, trajtohen në të gjitha rrethanat në mënyrë njerëzore.²² Aktet e renditura në nenin e përbashkët 3(1)(a)-(d) – që pasqyrohen edhe në nenin 14(1)(c)(i)-(iv) – janë shembuj joshterues të akteve të ndaluara.²³ Akte të tjera në mospajtim me 'trajtimin njerëzor' – ndër të cilët edhe ndalimi arbitrar – gjithashtu janë të ndaluara dhe përfshihen në fushëveprimin e nenit 14(1)(c).

12. Respektimi i të drejtave themelore, të papezullueshme – si mbrojtja nga ndalimi arbitrar²⁴ – është një komponent i domosdoshëm i garantimit të trajtimit njerëzor sipas nenit të përbashkët 3.²⁵ Në veçanti, sikurse vërejnë Gjykata Supreme e Kosovës²⁶ dhe

²² Neni i përbashkët 3, para. 1 ('Personat që nuk marrin pjesë aktive në luftime, përfshirë edhe pjesëtarët e forcave të armatosura që kanë dorëzuar armët dhe ata që janë jashtë luftimit për arsye të sëmundjes, plagëve, ndalimit, ose çfarëdo shkakut tjetër, trajtohen në të gjitha rrethanat në mënyrë njerëzore, pa dallim të pafavorshëm ndaj tyre mbi bazën e racës, ngjyrës, fesë ose besimit, seksit, origjinës së lindjes ose pasurisë, ose çfarëdo kriteresh të tjera të ngjashme.'). Kushti për trajtim njerëzor është parim themelor mbi të cilin mbështetet neni i përbashkët 3 dhe katër Konventat e Gjenevës. *Shih* Komentar për Konventën e Parë të Gjenevës, 1952, ('Komentari i vitit 1952'), f. 52; ICRC/KNKK, Komentar për Konventën e Parë të Gjenevës, 2016, ('Komentari i vitit 2016'), para. 550-551; ICRC/KNKK, Komentar për Konventën e Dytë të Gjenevës, 2017, ('Komentari i vitit 2017'), para. 572-573; ICRC/KNKK, Komentar për Konventën e Tretë të Gjenevës, 1960, ('Komentari i vitit 1960'), f. 38; ICRC, Komentar për Konventën e Katërt të Gjenevës, 1958, ('Komentari i vitit 1958'), f. 38.

²³ Komentari i vitit 1952, f. 53-54; Komentari i vitit 1958, f. 38-39; Komentari i vitit 1960, f. 35-36; Komentari i vitit 2016, para. 554-555; Komentari i vitit 2017, para. 575-576. *Shih gjithashtu* neni 14(1)(c) që i referohet 'shkelje të rënda të nenit të përbashkët 3 të katër Konventave të Gjenevës, të 12 gushtit 1949, duke përfshirë çdonjërin prej veprimeve të mëposhtme [...] (theksimi i shtuar).

²⁴ HRC/KDNJ, *General Comment No. 35*, neni 9: Liria dhe siguria e personit, ('Koment i Përgjithshëm nr. 35'), para. 66 ('garancia themelore kundër ndalimit arbitrar është e papezullueshme, [...]').

²⁵ Komentari i vitit 1952, f. 48 (neni i përbashkët 3 'garanton rregullat e njerëzimit që pranohen si thelbësore nga kombet e civilizuar'); ICRC/KNKK, Komentar mbi Protokollin Shtesë II, 1987, para. 4521, 4523 (trajtimi njerëzor 'përfshin të gjitha të drejtat e individit, përkatësisht të drejtat dhe cilësitë që janë të pandashme nga qenia njerëzore për vetë faktin e ekzistencës së tij dhe të kompetencave të tij mendore dhe fizike').

²⁶ Gjykata Supreme e Kosovës, *L. Gashi et al.*, Plm. Kzz. 18/2016, Vendim fajësie, 13 maj 2016 ('Aktgjykimi *Gashi*'), para. 58 ('gjatë konfliktit të armatosur civilët trajtohen në mënyrë njerëzore, ndërsa heqja arbitrare e lirisë dhe rrahjet nuk janë në pajtim me këtë kusht.')

KNKK-ja, 'neni i përbashkët 3 i Konventave të Gjenevës si edhe të dy Protokollet Shtesë I dhe II, kërkojnë që të gjithë civilët dhe personat jashtë luftimit të trajtohen në mënyrë njerëzore (shih rregullën 87), ndërsa heqja arbitrare e lirisë nuk është në pajtim me këtë kusht'.²⁷

13. Moslejimi i ndalimit arbitrar njihet në të drejtën zakonore ndërkombëtare, përfshirë edhe në kontekstin e konflikteve të armatosura jondërkombëtare.²⁸ Ky moslejim sipas të drejtës zakonore ndërkombëtare bazohet në praktikën e shteteve²⁹ dhe në të drejtën humanitare ndërkombëtare dhe të drejtën e të drejtave të njeriut.³⁰ Në të vërtetë, ndalimi nuk lejohet askund në të drejtën ndërkombëtare apo në praktikat shtetërore, përveçse për arsye të ligjshme.³¹

14. Më tej, standardi për trajtim njerëzor zbatohet njësoj në të gjithë të drejtën humanitare ndërkombëtare.³² Ndalimi arbitrar pranohet gjerësisht si sjellje që shkel

²⁷ ICRC/KNKK, *Customary International Humanitarian Law*, Jean-Marie Henckaerts dhe Louise Doswald-Beck Vëllimi I: Rregullat, 2005 (rishtypur me korrigjime në 2009) ('Studimi i KNKK-së mbi DZN-në'), rregulla 99, f. 344.

²⁸ Studimi i KNKK-së mbi DZN-në, rregulla 99, f. 344. *Shih gjithashtu* Inter-American Commission on Human Rights, *Third Report on the Human Rights Situation in Columbia*, 26 shkurt 1999, para. 300 (që konsideron në kontekstin e një konflikti të brendshëm të armatosur se 'ndalimet nga grupet paramilitare mund të konsiderohen se përbëjnë heqje arbitrare të lirisë, në shkelje të së drejtës humanitare ndërkombëtare').

²⁹ *Shih* Studimi i KNKK-së mbi DZN-në, f. 347-348. Shumica e ligjeve shtetërore dhe manualeve ushtarake mbi të cilat u mbështet KNKK-ja, përfshirë atë të Republikës Socialiste Federative të Jugosllavisë, ishin në fuqi midis viteve 1998 dhe 2000.

³⁰ Studimi i KNKK-së mbi DZN-në, rregulla 99, f. 344, 347-352. *Shih gjithashtu* Deklarata Universale e të Drejtave të Njeriut ('DUDNJ'), neni 9; Konventa Ndërkombëtare për të Drejtat Civile dhe Politike ('KNDKP'), neni 9; Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut ('KEDNJ'), neni 5; *American Convention on Human Rights* ('ACHR/KADNJ'), neni 7; Aktgjykimi *Gashi*, para. 57 ('e drejta humanitare ndërkombëtare dhe e drejta e të drejtave të njeriut parandalojnë rreptësisht mbajtjen në ndalim, përveçse për nevoja të përcaktuara mirë, në veçanti nevoja të sigurisë, dhe parashohin kushte dhe procedura të caktuara për parandalimin e zhdukjes dhe mbikëqyrjen e nevojës për vazhdim të mbajtjes në ndalim').

³¹ Studimi i KNKK-së mbi DZN-në, rregulla 99, f. 347 ('nuk u konstatua asnjë praktikë zyrtare e kundërt, qoftë në lidhje me konfliktet e armatosura ndërkombëtare ashtu edhe ato jondërkombëtare. Rastet e pretenduara të heqjes së paligjshme të lirisë janë dënuar').

³² Komentari i vitit 2017, para. 1422 ('duke pasur parasysh se ai bazohet në konceptin themelor të dinjitetit njerëzor, standardi i trajtimit njerëzor është i njëjtë për të gjitha kategoritë e personave të mbrojtur dhe është njësoj i zbatueshëm si për konfliktet e armatosura ndërkombëtare ashtu edhe ato jondërkombëtare'); ICTY/TPNJ, *Prosecutor v. Delalić et al./Prokurori kundër Delalijit et al.* IT-96-21-T, Aktgjykim, 16 Nëntor 1998 ('*Delalić et al.*, Vendim i gjykimit'), para. 543 ('aktet që Konventat dhe Komentaret i karakterizojnë si çnjerëzore ose që janë në mospajtim me parimin e humanizmit, përbëjnë shembuj të veprimeve që mund të karakterizohen si trajtim çnjerëzor').

parimin e trajtimit njerëzor, përfshirë edhe në formën e izolimit të paligjshëm të personave të mbrojtur si një shkelje e rëndë e Konventave të Gjenevës,³³ dhe të burgimit si krim kundër njerëzimit.³⁴

15. Së fundi, të drejtat e gjykimit të drejtë, të garantuara në nenin e përbashkët 3(1)(d)³⁵ janë pashmangshmërisht në mospërputhje me mundësinë e lejimit të ndalimit arbitrar në një konflikt të armatosur jondërkombëtar. Do të ishte e pakuptimtë që një palë në konflikt të detyrohet të respektojë të drejtat për gjykim të drejtë të një personi të ndaluar në qoftë se në të njëjtën kohë ajo palë është e lirë ta anashkalojë këtë kusht duke kryer ndalime pa asnjë bazë ligjore apo garanci procedurale elementare.³⁶ Rrjedhimisht, moslejimi i ndalimit arbitrar, si standard, është i nënkuptuar në nenin e përbashkët 3.

b. Ndalimi arbitrar është i rëndë

16. Ndalimi arbitrar është ‘i rëndë’ në kuptimin e nenit 14(1)(c), sepse përbën shkelje të një rregulle që mbron vlera të rëndësishme, që përfshin pasoja të rënda për viktimën.³⁷ Sikurse u parashtrua më lart, mbrojtja nga ndalimi arbitrar përbën një të

³³ Komentari i vitit 2016, para. 2977-2978 (që e përshkruan trajtimin çnjerëzor si “ombrellën” nën të cilën përfshihen të gjitha shkeljet e rënda; izolimi i paligjshëm i civilëve është shkelje e rëndë sipas nenit 147 të Konventës së Katërt të Gjenevës); *Delaliq et al.*, Vendim i gjykimit, para. 543 (që po ashtu i përshkruan shkeljet e rënda si të përfshira nën ombrellën e trajtimit çnjerëzor). *Shih gjithashtu* ICTY/TPNJ, *Prosecutor v. Blaškić/Prokurori kundër Blashkiqit*, IT-95-14-T, Aktgjykim, 3 mars 2000, para. 154.

³⁴ Neni 13(1)(j) (‘akte të tjera çnjerëzore’) (theksimi i shtuar) përcakton se krimet e tjera kundër njerëzimit të renditura, përfshirë burgimin (neni 13(1)(e)), janë gjithashtu çnjerëzore. *Shih gjithashtu: Report of the Secretary-General Pursuant to Paragraph 2 of Security Council Resolution 808 (1993)*, S/25704, 3 maj 1993, para. 48 (‘Krimet kundër njerëzimit u referohen akteve çnjerëzore të një natyre shumë të rëndë’ (theksimi i shtuar)).

³⁵ *Shih gjithashtu* nenin 14(1)(c)(iv) dhe nenet 2(2) dhe 6 të Protokollit Shtesë II.

³⁶ *Shih, po ashtu*, Koment i Përgjithshëm nr. 35, para. 14 (‘regjimi nuk duhet të përbëjë shmangie prej kufizimeve mbi sistemin e drejtësisë penale duke dhënë barasvlerësin e ndëshkimit penal pa mbrojtjet përkatëse’). *Shih gjithashtu* ECCC, *Nuon and Samphan*, 002/19-09-2007/ECCC/TC, Case 002/02, Aktgjykim, 16 Nëntor 2018 (‘Çështja 002/02, Vendim i gjykimit’), para. 2584 (‘arrestimet arbitrarë, mosdhënia sistematike e informacionit dhe mungesa sistematike e detajimit të mjaftueshëm të akuzave kundër të burgosurve, që pretendohet të ishin shkak i ndalimit të tyre, mbajtja e tyre të ndaluar për një kohë të gjatë pa qasje në garancitë procedurale apo çfarëdo mundësie për të kundërshtuar ndalimin e tyre – të gjitha demonstrojnë mohim flagrant, të qëllimshëm dhe të vazhdueshëm të të drejtave të procesit të rregullt ligjor dhe përbëjnë ndalim arbitrar në kundërshtim me të drejtën ndërkombëtare’).

³⁷ *Shih, po ashtu*, ICTY/TPNJ, *Prosecutor v. Tadić/Prokurori kundër Tadiqit*, IT-94-1-PT, Decision on the Defence Motion for Interlocutory Appeal on Jurisdiction/Vendim për mocionin e mbrojtjes për apel të

drejtë themelore të papezullueshme.³⁸ Moslejimi i ndalimit arbitrar mbron të drejtat për jetë, liri dhe siguri të personit.³⁹ Sipas Komisionit për të Drejtat e Njeriut, 'liria dhe siguria e personit janë të vyera në vetvete, dhe gjithashtu sepse heqja e lirisë dhe sigurisë së një personi ka qenë historikisht mjet parësor për cenimin e gëzimit të të drejtave të tjera'.⁴⁰ Në të vërtetë, ndalimi arbitrar krijon ose shton rrezikun e torturës dhe keqtrajtimeve të tjera.⁴¹

17. Këto konsiderata janë veçanërisht të rëndësishme në një kontekst ku ndalimi arbitrar u krye në shkallë shumë të gjerë dhe ishte pjesë përbërëse e sjelljes së kryesve, sikurse është rasti i konfliktit të armatosur nën shqyrtim.⁴²

c. Elementët

18. Elementët bazë të ndalimit arbitrar janë përkufizuar vazhdimisht, përfshirë edhe në kontekstin e izolimit të paligjshëm si shkelje e rëndë dhe të burgimit si krim kundër njerëzimit. Duke pasur parasysh që moslejimi i ndalimit arbitrar është element i përbashkët i së drejtës humanitare ndërkombëtare dhe i së drejtës të të drejtave të njeriut,⁴³ në përkufizimin e elementëve të ndalimit arbitrar, gjykatat kanë marrë parasysh garancitë procedurale dhe garancitë e tjera në Konventat e Gjenevës, Protokollat Shtesë të Konventave të Gjenevës dhe instrumentet e të drejtave të njeriut, si Deklarata Universale për të Drejtat e Njeriut, Konventa Ndërkombëtare për të Drejtat Civile dhe Politike, Konventa Amerikane për të Drejtat e Njeriut, dhe Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut dhe Lirive Themelore.⁴⁴

ndërmjetëm mbi juridiksionin, 2 tetor 1995, para. 90, 94(iii) (që shqyrton standardin e shkeljes 'së rëndë' të ligjeve ose zakoneve të luftës në kuptim të nenit 3 të Statutit të TPNJ-së).

³⁸ *Shih* para. 12 më lart; Koment i Përgjithshëm nr. 35, para. 66 ('garancia themelore kundër ndalimit arbitrar është e papezullueshme, [...]').

³⁹ Koment i Përgjithshëm nr. 35, para. 2, 55. *Shih gjithashtu* Studimi i KNKK-së mbi DZN-në, rregulla 99, f. 344 (që vë në dukje rolin e kritereve procedurale të moslejimit në parandalimin e zhdukjeve).

⁴⁰ Koment i Përgjithshëm nr. 35, para. 2.

⁴¹ Koment i Përgjithshëm nr. 35, para. 33, 56, 58.

⁴² Kjo është e vërtetë jo vetëm në lidhje me akuzat që tashmë janë parashtruar, por edhe për një varg më të gjerë sjelljesh që janë objekt i hetimeve në vijimësi të ZPS-së dhe të cilat me gjasë do të përbëjnë objektin e procedurave të ardhshme.

⁴³ *Shih* para. 12-15 më lart.

⁴⁴ *Shih, për shembull*, ICTY/TPNJ, *Prosecutor v. Prlić et al./Prokurori kundër Përliqit et al.* IT-04-74-A, Aktgjykim, 29 Nëntor 2017 ('Përliq et al., Aktgjykim i Apelit'), para. 471-473 dhe burimet e cituara në të;

19. Këta elementë bazë, përveç elementëve përkatës kontekstualë dhe kushteve të përgjithshme të nenit të përbashkët 3,⁴⁵ janë:⁴⁶

- (i) heqja e lirisë së një individi pa proces të rregullt ligjor;⁴⁷ dhe
- (ii) synimi për t'i hequr lirinë individit pa proces të rregullt ligjor ose duke pasur dijeni të arsyeshme se veprimi ose mosveprimi me gjasë do të shkaktojë heqjen arbitrare të lirisë.

d. Ndalimi arbitrar është në shkelje të nenit 142 të Kodit të RFJ-së

20. Ndalimi arbitrar, i përshkruar si 'arrestim dhe ndalim i paligjshëm', po kështu ndalohet shprehimisht si krim lufte në nenin 142 të Kodit të RFJ-së, i përfshirë në juridiksionin e Dhomave të Specializuara përmes nenit 15(1)(a).

21. Aktet e renditura në nenin 142 të Kodit të RFJ-së parashihen si vepra penale për aq sa përbëjnë shkelje 'të rregullave të së drejtës ndërkombëtare që janë në fuqi në

ICTY, *Prosecutor v. Krnojelac/Prokurori kundër Kërnojelacit*, IT-97-25-T, Aktgjykim, 15 mars 2002 ('*Krnojelac*, Vendim i gjykimit'), para. 113; Çështja 002/02, Vendim i gjykimit, para. 692-693, 780. *Shih gjithashtu ICC/GJPN, Situation in the Republic of Burundi, Public Redacted Version of "Decision Pursuant to neni 15 of the Rome Statute on the Authorization of an Investigation into the Situation in the Republic of Burundi"*, ICC-01/17-X-9-US-Exp, 25 tetor 2017 ('Vendimi i Burundit'), para. 68.

⁴⁵ Neni 14(1)(c), (2).

⁴⁶ *Shih, po ashtu*, mbi përkufizimin e shkeljes së rëndë të izolimit të paligjshëm: ICTY/TPNJ, *Prosecutor v. Kordić and Čerkez/Prokurori kundër Kordiqit dhe Čerkezit*, IT-95-14/2-T, Aktgjykim, 26 shkurt 2001, para. 298, 301; ICTY/TPNJ, *Prosecutor v. Kordić and Čerkez/Prokurori kundër Kordiqit dhe Čerkezit*, IT-95-14/2-A, Aktgjykim, 17 dhjetor 2004 ('*Kordiq dhe Čerkez*, Aktgjykim i Apelit'), para. 73; dhe për përkufizimin e burgimit si krim kundër njerëzimit: *Kordiq dhe Čerkez*, Aktgjykim i Apelit, para. 116; *Kërnojelac*, Vendim i gjykimit, para. 115; Çështja 002/02, Vendim i gjykimit, para. 689, 697. *Shih gjithashtu* Vendimi i Burundit, para. 68.

⁴⁷ Heqja e lirisë është konsideruar se është arbitrare ose e paligjshme, dhe rrjedhimisht pa proces të rregullt ligjor, në një shumëllojshmëri të madhe rrethanash që përfshijnë, ndër të tjera, kur nuk ka bazë ligjore, ose kur baza ligjore nuk është e kuptueshme, e qasshme, prapavepruese, ose nuk zbatohet në mënyrë të përputhshme, të parashikueshme e të barabartë për të gjithë, ndalimi nuk bazohet mbi një dyshim të arsyeshëm ose të mirëfilltë, ndalimi vazhdon pasi baza ligjore pushon së ekzistuari, ose ndalimi nuk është në përputhje me procedurat e përcaktuara me ligj. *Shih, për shembull, Përliq et al.*, Aktgjykim i Apelit, para. 471-472; ICTY, *Prosecutor v. Krajisnik/Prokurori kundër Krajishnikut*, IT-0039-T, Aktgjykim, para. 753; Koment i Përgjithshëm nr. 35, para. 11, 17, 22-23, 43-44; Çështja 002/02, Vendim i gjykimit, para. 692-693, 2579-2580, 2584; HRC/KDNJ, *Report of the Working Group on Arbitrary Detention*, A/HRC/22/44, 24 dhjetor 2012, Përfundim nr. 9 lidhur me përkufizimin dhe fushëveprimin e heqjes arbitrare të lirisë sipas të drejtës zakonore ndërkombëtare, para. 62-63; UN OHCHR, *Fact Sheet No 26, The Working Group on Arbitrary Detention*, maj 2000; Vendimi i Burundit, para. 68, 89.

kohë lufte'.⁴⁸ Sikurse u përshkrua më lart, ndalimi arbitrar përbën shkelje të së drejtës zakonore humanitare ndërkombëtare të zbatueshme në një konflikt të armatosur jondërkombëtar, të nenit të përbashkët 3, dhe të së drejtës ndërkombëtare të të drejtave të njeriut.⁴⁹

22. Për rrjedhojë, elementët e ndalimit arbitrar në kuadër të nenit 142 të Kodit të RFJ-së, në përputhje me moslejimin e tyre sipas së drejtës ndërkombëtare, përveç elementëve përkatës kontekstualë, janë:

- (i) heqja e lirisë së një individi pa proces të rregullt ligjor; dhe
- (ii) synimi për t'i hequr individit lirinë pa proces të rregullt ligjor ose duke pasur dijeni të arsyeshme se veprimi ose mosveprimi me gjasë do të shkaktojë heqjen arbitrare të lirisë.

V. KLASIFIKIMI

23. Ky parashtrim dhe shtojcat e tij dorëzohen për protokollim si rreptësisht konfidenciale dhe *ex parte* në përputhje me rregullën 82(4).

VI. MASAT QË KËRKOHEN

24. Për arsyet e lartpërmendura, ZPS-ja kërkon që gjykatësi i procedurës paraprake:

- a. të konfirmojë Aktakuzën e Rishikuar;
- b. të lëshojë fletarrestim, autorizim për kontroll dhe sekuestrim, dhe urdhër transferimi, sipas kushteve të kërkuara në pjesën B(4)-(5) të Parashtrimit Fillestar;

⁴⁸ Neni 142 i Kodit të RFJ-së ('Kushdo që në shkelje të rregullave të së drejtës ndërkombëtare në fuqi në kohë lufte, konflikti të armatosur, ose pushtimi, [...]'). *Shih gjithashtu* nenin 12.

⁴⁹ *Shih* para. 11-15 më lart. Pranohet gjerësisht se e drejta humanitare ndërkombëtare, përfshirë të drejtën e personit për liri dhe siguri, vazhdon të jetë e zbatueshme në kohë konflikti të armatosur. *Shih* Koment i Përgjithshëm nr. 35, para. 64; Gjykata Ndërkombëtare e Drejtësisë, *Legal Consequences of the Construction of a Wall in the Occupied Palestinian Territory*, Mendim këshillues, Raporte të GJND-së 2004, f. 178, para. 106.

- c. të urdhërojë mosnxjerrjen e përkohshme të identiteteve të dëshmitarëve dhe viktimave, sipas kushteve të kërkuara në pjesën C të Parashtrimit Fillestar dhe paragrafin 8 më lart; dhe
- d. të urdhërojë mosnxjerrjen përkohësisht në publik të Aktakuzës së Rishikuar, dokumenteve dhe informacionit të lidhur me të, sipas kushteve të kërkuara në pjesën D të Parashtrimit Fillestar.

Numri i fjalëve në anglishte: 3928

/nënshkrim/

Xhek Smith

Prokurori i Specializuar

E hënë, 26 prill 2021

Në Hagë, Holandë.